



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 26.03.2025

Numër Protokolli: 2094/2025

A.nr.310/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtare, me Avdyl Bektashi në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.310/2025 të datës 12.02.2025, të parashtruar nga ankuesi A.P., të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat Jeton Osmani, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike *“masë disiplinore”*, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 1, paragrafi 3, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të nenit 132 paragrafi 2 të LPPA-së, me datë 26.03.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.310/2024, e datës 12.02.2023, e parashtruar nga ankuesi A.P.

**II. Mbetet në fuqi** Vendimi KD:Nr.01/2025, i datës 08.01.2025, të Komisionit Disiplino, të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

## A r s y e t i m

Ankuesi A.P. (*tutje referuar vetëm* Ankuesi), më datë 12.02.2024, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KD:Nr.01/2025, të datës 08.01.2025, të protokolluar me datë 13.10.2025, të Komisionit Disiplinor të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetimit të gabueshëm ose vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, administroi këto prova:** Ankesën me numër protokolli 953/2025 të datës 12.02.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin KD:Nr.01/2025, të datës 08.01.2025, të protokolluar me datë 13.10.2025, të Komisionit Disiplinor i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Vendimin A.nr.1573/2024 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën me numër protokolli 5522/2024 të datës 17.10.2024, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin KD:Nr.16/2024, të datës 09.09.2024, të protokolluar me datë 10.10.2024, të Komisionit Disiplinor të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datë 21.10.2024; Përgjigjen në ankesë e datës 28.10.2024; Akt Emërimit me Nr. 658/2024 të datës 01.08.2024; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinor të datës 09.09.2024; Lajmin e publikuar në TV klan dhe shkrimin e bërë; Procesverbalin e seancës së Komisionit Disiplinor i datës 18.09.2024 dhe 19.09.2024; Vendimin e datës 08.02.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të SKPK; Kërkesën për kthimin në vendin e punës e datës 09.02.2023 të ankuesit; Aktgjykimin PKR.nr.314/21 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda; Aktgjykimin PSKR.nr.158/2022 i Gjykatës së Apelit të Kosovës; Vërejtjen me shkrim të datës 12.03.2024 për ankuesin; Shkresën e datës 01.03.2024 nga Gjykata Themelore në Prishtinë; Njoftimin për kontroll mjekësor datës 12.03.2024; Vendimin A.nr.392/2024 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës për ankuesin i datës 30.01.2024.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankuesit është e pabazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesi sipas Akt Emërimit me Nr. 658/2024, të datës 01.08.2024, është i punësuar në pozitën *Udhëheqës Regjional* në Zyrën për Mbrojtjen dhe Ndihmë Viktimave, në Regjionin e Prishtinës, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Tutje sipas shkresave të lëndës rezulton së u.d. Koordinatori i Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave, më datë 09.09.2024, ka parashtruar kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit me arsyetimin se: *Më datë 03.09.2024 në mediumin publik TV-klan publikohet komunikimi me video dhe audio incizim ku, z. Popaj shihet dhe dëgjohet se me komunikimet e tij të publikuara ka dëmtuar rënd institucionin e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave dhe institucionin e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit si dhe institucionet tjera. Publikimin e plotë mund ta gjeni në Tvklan.al të datës 03.09.2024 në emisionin STOP me titull “Shkon për ankesë, kreu që mbron viktimat e dhunës e ngacmon seksualisht” Duke vlerësuar se i njëjti ka bërë shkele të nenit 56 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1, 4.5, 4.6, 4.7, 4.14, 4.18 dhe 4.20 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë.*

Komisioni Disiplinor i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, më Vendimin KD:Nr.16/2024, të datës 09.09.2024, i protokolluar më datë 10.10.2024, ka shpallur përgjegjësin ankuesin për shkelje të rënda disiplinore sipas nenit 56 paragrafi 4, nën paragrafi 4.1, 4.5, 4.6, 4.7 dhe 4.18 të Ligjit Nr. 08/L-187 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 3, nën paragrafi 3.2, 3.6, 3.7 3.8 dhe 3.23 të Rregullores Nr. 05/2024 për Procedurën Disiplinor të Stafit Administrativ në Sistemin Prokurorial të Kosovës, duke shqiptuar ndaj të njëjtit masën disiplinore *Ulje në Pozitë-Zyrtar Administrativ* në Zyrën për Mbrojtjen dhe Ndihe Viktimave në Zyrën Regjionale në Prishtinë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke vepruar sipas ankesës së ankuesit të datës 17.10.2024, ta parashtuar kundër Vendimit KD:Nr.16/2024, të datës 09.09.2024, të Komisionit Disiplinor të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, më Vendimin A.nr.1573/224, të datës 06.12.2024, ka aprovuar si të bazuar ankesën e ankuesit, duke anuluar, vendimin e kontestuar dhe çështjen kthen në rishqyrtim dhe rivendosje tek Komisioni Disiplinor i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Komisioni Disiplinor i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në procedurë të rishqyrtimit të rastin sipas Vendimit A.nr.1573/2024 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.01.2025 ka marr Vendim KD:Nr.01/2025, të protokolluar më datë 13.01.2024, me të cilin ankuesin e ka shpallur përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore, të parashikuar me nenin 56 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1, 4.5, 4.6, 4.7 dhe 4.18 të Ligjit Nr. 08/L-187 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 3 nën paragrafi 3.2, 3.6, 3.7 3.8 dhe 3.23 të Rregullores Nr. 05/2024 për Procedurën Disiplinor të Stafit Administrativ në Sistemin Prokurorial të Kosovës, duke i shqiptuar masën disiplinore *“Ulje në Pozitë”*.

Ankuesi, në ankesën e parashtuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KD:Nr.01/2025 të datës 08.01.2025, të protokolluar me datë 13.01.2025, të Komisionit Disiplinor të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, pretendon se Komisioni Disiplinor nuk ka konstatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, sepse nuk ka konstatuar se në bazë të cilave fakte është vërtetuar shkelja dhe për rrjedhojë janë shkelje të parimeve për gjykim të drejtë. Shton se vendimi i kontestuar me ankesë, nuk përmban bazë ligjore dhe se ankuesit nuk është dhënë mundësia e kundërshtimit të provave. Kërkon që ankesa të aprovohet ankesa si e bazuar dhe të anulohet vendimi i kundërshtuar me ankesë.

Në kuptim të pranueshmërisë së ankesës, Kolegji i Këshillit, i'u referua dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (tutje LPPA), me të cilin përcaktohet se: *1. Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.1. nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji; 1.2. ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 124 të këtij Ligji; 1.3. ajo është parashtuar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji, dhe 1.4. çfarëdo kushte të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj.*, dhe si rrjedhojë, Kolegji konstaton se ankesa është e pranueshme, nga ankuesi ka legjitimitetin e palës dhe se ankesa është ushtruar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 1, të LPPA-së dhe si rrjedhojë Këshilli ka juridiksion për trajtimin

e kësaj çështje siç përcaktohet me nenin 101 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Lidhur statusin e të punësuarve në administratën e Prokurorisë së Shtetit, Kolegji i Këshillit iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtaret Publikë, gjegjësisht:

-Nenit 1 [Qëllimi] ku përcaktohet se: *Ky ligj ka për qëllim rregullimin e marrëdhënies së punës së zyrtares/it publik në institucionet e Republikës së Kosovës, përkatësisht përcaktimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë pranimin, klasifikimin e pozitave, ndryshimin, përfundimin e marrëdhënies së punës, të drejtat dhe detyrimet në raport me marrëdhënien e punës, si dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me marrëdhënien e punës së zyrtares/it publik në institucionet e Republikës së Kosovës.*

-Nenit 5 [Kategoritë e zyrtares/it publik] ku përcaktohet se: *1. Kategoritë e zyrtares/it publik janë: 1.1. Nëpunësja/i i shërbimit civil; 1.2. Nëpunësja/i i shërbimit publik; 1.3. Krijuesja/i dhe performuesja/i e/i artit dhe kulturës; 1.4. Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës; dhe 1.5. Zyrtarja/i i kabinetit.*

-Nenit 6 [Nëpunësja/i civil me status të veçantë] paragrafi 4 ku përcaktohet se: *4. Të punësuarat/it e administratës në kuadër të sistemit të drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, Presidencës, Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe institucioneve të pavarura kushtetuese janë nëpunës civil me status të veçantë, rregullimi i të cilëve bëhet me akt të veçantë.*

Bazuar në kuadrin përkatës ligjor, Kolegji thekson faktin se të punësuarit e administratës në Prokurorinë e Shtetit janë nëpunës civilë me status të veçantë, rregullimi i të cilëve bëhet me akt të veçantë, rrejdhimisht, meqenëse Prokuroria e Shtetit ka të miratuar akt të veçantë që rregullon çështjen disiplinore të të punësuarve të administratës në këtë institucion, rrejdhimisht Rregulloren Nr.05/2024 për Procedurën Disiplinore të Stafit Administrativ në Sistemin Prokurorial të Kosovës, atëherë, lidhur me trajtimin e kësaj çështje ankimore aplikohen dispozitat e kësaj rregullore në ndërlidhje me Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Referuar përcaktimit si me sipër, Kolegji ve theksin të dispozitat e nenit 4, 5, 6 12, 17 të Rregullores Nr. 05/2024 për Procedurën Disiplinore të Stafit Administrativ në Sistemin Prokurorial të Kosovës, me të cilat përcaktohet se:

- Nenit 4 paragrafi 1, përcakton: *Stafi administrativ në SPKP mban përgjegjësi disiplinore për shket ë detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bënë zbatim jo të duhur të tyre, apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me aktet normative në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim.*

-Nenit 5 paragrafi 1, ku përcaktohet: *Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pafshira; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit.*

-Nenit 6, ku përcaktohet: *Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi të punë mund të jenë: 1.1, shkelej të lehta dhe 1.2. shkele të rënda. 2. Shkelje të lehta konsideroheni: 2.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune radhazi; 2.2. mosrespektimi i orarit të punës; 2.3. sjellja jo e mirë gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 2.4 shkelja e kodit të Etikës Profesionale për punonjësit mbështetës të sistemit prokurorial. 3. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos deklarim i konfliktit të interesit në rastet kur ka dijeni, 3.2. mospërbushja e detyrave të punës; 3.3. neglizhencë e vazhdueshme në përmbushje të detyrave të punës; 3.4. mosrespektimi i afateve të caktuara për përmbushjen e detyrave të punës; 3.5.moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.6. veprimet apo mosveprimet që kanë shkaktuar pasoja; 3.7. shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës; 3.8. sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit prokurorial; 3.9. vënia në lajthitje e sistemit prokurorial përmes dhënies së informatave të gabuara ose fshehja e të dhënave zyrtare kur kërkohen për qëllime zyrtare; 3.10. përfitimi apo ofrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale që ndodhin për shkak të detyrës; 3.11.braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vazhdueshme për tri (3) ose më shumë ditë pune; 3.12. përsëritja e shkeljeve të lehta disiplinore dy (2) apo më shumë herë; 3.13. moslajmërimi i shkeljeve të rënda që lidhet me detyrat e punës nga stafi administrativ i sistemit prokurorial; 3.14. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.15.kryerja e aktiviteteve që bien ndesh me interesat e sistemit prokurorial apo veprimet që dëmtojnë sistemin prokurorial apo organet tjera shtetërore; 3.16.Sjellaj apo kërcënimi që u pamundëson, i pengon apo u vështrojnë të tjerëve kryerjen e detyrave zyrtare të punës; 3.17.fshehja e fakteve, provave apo të dhënave zyrtare, kur ato kërkohen me qëllime zyrtare, 3.18. mosruajtja e konfidencialitetit në lidhje me informacionet që janë të rëndësishme për institucionin gjatë kryerjes së detyrave të punës; 3.19. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit dhe dokumenteve të klasifikuara; 3.20. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera narkotike të ndaluara; 3.21. përdorimi i alkoolit në vend të punës ose ardhja i dehur në punë; 3.22. keqpërdorimi i detyrës zyrtare lidhur me procedurën e rekrutimit nga anëtarët/ët e komisionit të rekrutimit që janë shërbyes civil; 3.23. ngacmimet në vendin e punës apo gjatë ushtrimit të detyrës, që cenojnë integritetin moral dhe fizik, si dhe ato seksuale; 3.24. diskriminimi mbi baza gjinore, racore dhe të tjera, sipas ligjit përkatës kundër diskriminimit; 3.25. shkelja e detyrimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.*

-Nenit, 12 paragrafi 1: *Komision i Disiplinor ka këto kompetenca, 1.1. të shqyrtoj provat lidhur me shkeljen e supozuar, 1.2.Tëq vendos në bazë të provave nëse është kryer shkelja dhe 1.3.3 Të përcaktoj masën që duhet shqiptuar.*

Nenit 17 paragrafi 3, ku përcaktohet: *Masat disiplinore për shkelje të detyrave të punës, të përcaktuar me nenin 5 të kësaj rregulloreje, stafit administrativ sistemit prokurorial mund t'i shqiptohen këto masa disiplinore: 3.1.ndalimi i njëzetë për qind (20%)deri në pesëdhjetë (50%) të pagës bazë për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj; 3.2. ndalimi i avancimit/emërimit në kategori më të lartë, për një periudhë nga një (1) deri në pesë (5) vite; 3.3. transferimi në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë; 3.4. ulja në pozitë; 3.5. pezullimi nga pozita pa pagesë deri në gjashtë (6) muaj; 3.6. pezullimi nga pozita me ndalim deri në pesëdhjetë për qind (50%) të pagës bazë, deri në një (1) vit; 3.7. largimi nga shërbimi civil.*

Kolegji i Këshillit në kuptim të dispozitave ligjore si me lartë e në mbështetje të nenit 88 dhe 89 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka analizuar Vendimin KD:Nr.01/2025, i datës 08.01.2025,,ë Komisionit Disiplinor të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në ndërlidhje me provat tjera materiale të parashtruara nga palët në procedurë dhe si rrjedhojë konstatoi së Komisioni Disiplinor ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen e fakteve lidhur me çështjen disiplinore të ankuesit, si dhe ka zbaruar drejt ligjin material, më arsyet se sipas provave materiale vërtetohet së më datë 03.09.2024 në TV Klan në Republikën e Shqipërisë në emisionin “STOP”, është publikuar lajmi ***Shkon për ankesë, kreu që mbron viktimat e dhunës e ngacmon seksualisht***, dhe së nga vet shikimi i emisionit (i cili gjendet edhe ne kanalin Youtube) del se ankuesi gjatë orarit të punës zhvillon takime jashtë objektit të punës më dy gra, ku i njëjti përveç bisedën që ka me palën, evidentohet ky komunikim me tyre citojmë: *Je e martuar*, ndërsa e njëjta i është përngjitur *JO*, vazhdon ankuesi me pyetje *Tash ke një njohje*, pala i përgjigjet *JO*, ankuesi me pyetje *Shumë mirë! Qenke perfekt! Me ndonjë lidhje! Perfekt*, pala i përgjigjet *JO JO!*, vazhdojnë pyetjet e ankuesit *Çfarë moshe ke!*, pala përgjigjet *E madhe*, ankuesi pyet *Mua nuk më dukesh*, pala përgjigjet *Nja xx,xx*, pyetje ankuesit *Shumë më e re*, *Ti kisha dhanë 22 e 23*, pala përgjigjet *Jo kaq shumë mos e ul*, pyet ankuesi *Ke mundësi që të punësohesh dhe gjykatë. Sa duash ke punë. Nashta nuk të pengohem me pyet*, pala përgjigje *Jo absolutisht*, ankuesi pyet *Unë jam në këtë punë që 23 vite dhe jam drejtor rajonal dhe zëvendës drejtor gjeneral. Pritet që ne vitin e ardhëm që t'i marrim punëtor të prokuroria. Pse të mos fillosh punë te unë? Qe prej 3 janari do të hapen vend pune*, pala përgjigjet *Do të ishte shumë mirë*. ankuesi. *Po i dorëzojmë të tërë në gjykatë me rehat...është vënë në lëvizje policia edhe policia po punon pak ngadal dhe nuk është ashtu qysh në Shqipëri. Policia po reagon ngadalë, shumë ngadalë po reagon.*

Për me tepër Kolegji në trajtim të kësaj çështje administrative si provë shqyrtoj edhe deklaratën e ankuesit, e regjistruar në procesverbalin e seancës së Komisionit Disiplinor të datës 18.09.2024, ku nder tjera ankuesi kishte deklaruar:....*ditën kur ka ardh gazetarja së bashku me palën është prezantuar se është vajza e tezes së palës me emrin Egla Tore nga Elbasani. Në ditën kur jemi takuar rreth orës 12:00 të ditës kam qenë në lokalin përballë Prokurorisë Themelore në Prishtinë duke drekuar në telefonin tim më ka thirr Albana. Ndërsa dhe ka kërkuar që të takohemi përgjigja ime ka qenë se jam duke drekuar dhe takohemi pas drekës në zyrë. E njëjta ka insistuar me u taku me mua ku edhe kam pranuar por për rastin nuk kemi biseduar në lokal por kemi biseduar gjëra të rëndomta. Gjatë bisedës e sipër vajza e tezës në thonjëza e potencuar më ka thënë shumë kam dëshirë me u punësua në sistemin e drejtësisë në Kosovës, ndërsa përgjigja ime ka qenë shumë e qartë edhe e*

*shkurtër nëse ke dëshirë me u punësua atëherë nëse ka ndonjë konkurs publik mundësh me konkurrua dhe nëse ki fat mundesh me u punësua. Është e vërtet se e kam pyet se sa vite i ke dhe a je e martuar por ko ka qene vetëm në kontekst të marrëdhënies së punës dhe në asnjë moment nuk kam dashur ta ngacmoj seksualisht dhe as nuk kam dashur të ndikon rreth kërkesës së saj për marrëdhënie pune pas që as edhe nuk kam person kompetent të ndikon dhe as të pranon në marrëdhënie pune...Është e vërtet se unë i kam thënë palës se policia e ka neglizhuar pak çështjen mirëpo jo me pretendimet që me ofendua apo fyer Policinë. .ndërsa lidhur me pyetjet e parashtruara nga anëtarët e Komisionit Disiplinor ankuesi përgjigjet: puna jonë është shume e vështirë me e kuptuar prej personave tjerë,. Nuk hymë zakonisht në shoqërore por nëse hymë në ndonjë mënyrë shaka apo diçka tjetër nuk hymë me keqpërdor atë por vetëm me qetësua dhe jo me dëmtuar atë. Misioni ynë është me i mbrojt të drejtat e tyre.....: nuk i komentoj institucionet e drejtësisë dhe nuk i zhbëj ato që i kam thënë më herët që Policia ka qenë pasive në rastin konkret pasi që personi i dyshimtë ka pas dy fletë arreste por asnjëherë nuk kam dashur ta fyej policinë.*

Andaj, nisur nga analiza e fakteve si me lartë, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin se me veprimet e ankuesit sikurse në rastin konkret manifestohen të gjitha elementet e shkeljes së rëndë disiplinore, që i janë ven në barrë më vendimin e kontestuar, sepse në vlerësimin e Kolegjit ankuesi si zyrtar publik, njëherazi edhe koordinator i Zyrës për Mbrojtjen dhe Ndihëm të Viktimave, me zhvillimin dhe bisedën që kishte zhvilluar sipas video incizimit të datës 03.09.2024 të emisionit “STOP” TV. Klan Shqipëri, i njëjti ka shpreh komunikim jo etik dhe jo profesional, sjelle jo profesionale dhe të pa përshtatshme, e të cilat sjellje dhe veprime kanë cenuar reputacionin e institucionit ku punon ankuesi si dhe të institucionet e tjera (policinë, gjykatën).

Referuar të gjeturave dhe konstatimeve si me sipër Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni Disiplinor mjaftueshëm ka argumentuar përgjegjësinë disiplinore të ankuesit, duke e shpallur përgjegjës për shkelje te rëndë disiplinore sipas nenin 56 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1, 4.5, 4.6, 4.7 dhe 4.18 të Ligjit Nr. 08/L-187 për Zyrtarët Publikë, dhe së masa disiplinore ndaj ankuesit është në raport të drejtë me shkeljet e konstatuar, andaj, akti i kundërshtuar është vendim i ligjshëm dhe i nxjerr në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren Nr. 05/2024 për Procedurën Disiplinore të Stafit Administrativ në Sistemin Prokurorial të Kosovës.

Theksuar si me lart, duke u bazuar në 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për*

*Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

*Lënda me numër A.nr.310/2025*

**Avdyl BEKTESHI**

Procesmbajtës

**Ardita Haxhnikaj Demi**

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit, A.P.;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në SKPK; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.